



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Nr. 437/2022
Datë: 01.12.2022

Kryeministri i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 94 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 6 (2.1 dhe 2.9) të Rregullores (QRK) - Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021 dhe Rregulloren (QRK) nr. 03/2022, nxjerr:

V E N D I M

1. Z. Goran Rakić lirohet nga detyra e Ministrit të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.
2. Z. Goran Rakić është i obliguar të bëjë deklarin e pasurisë, në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-050 për deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-228 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-050.
3. Obligohet Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeministri.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Vendimi i dërgohet:

- Z. Goran Rakić;
- Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- Të gjithë Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë Ministrave;
- Shefit të Stafit të Kryeministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.